



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5354 prot.

Himarë, më 21.11.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 46 datë, 21.11.2023

“PËR EMËRTIMIN E SALLËS MULTIFUNKSIONALE TË BASHKISË HIMARË”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Emërtimin e sallës multifunktionale të Bashkisë Himarë me emrin “Neço Muko”.
2. Ngarkohet drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

DREJTORI

Andon Xani

DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharemi

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBLIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5354 / 12 prot.

Himarë, më 21.11 2023

RELACION SQARUES

Lënda: “Për emërtimin e sallës multifunkionale të Bashkisë Himarë”.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Nisur nga investimi që Bashkia Himarë ka bërë së fundmi në sallën multifunkionale në Himarë si një hapësirë e përshtatshme për artistët e zonës dhe jo vetëm të shfaqin artin e tyre por dhe si një risi për qytetin e cila i kishte munguar. Nevoja për të patur një emër si sallë është marrë iniciativa nga ana e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetës për vendosjen e një emri bazuar dhe nga propozimet e bëra. Në kuadër të kësaj janë zhvilluar bisedime me shoqata kulturore dhe me këshillin kulturor të Bashkisë Himarë, ku janë bërë këto propozime për emrin e ri të sallës multifunkionale Himarë, si më poshtë:

Nga ana e shoqatës “Bejk e Bardhë” është propozuar emri Koço Çakalli, kurse nga ana e specialistes së kulturës znj. Katina Rika (Beleri), është propozuar emri Neço Muko.

➤ Koço Çakali

Koço Çakali ka lindur në Himarë në vitin 1900 në një familje artdashës. Dëshira për artin që në vitet e para të jetës së tij u edukua nga familja edukoi me këngët polifonike dhe artin në tërësi. Ai kontribuoi në arsimimin e fëmijëve të fshatit si dhe ishte njohës i mirë i katër gjuhëve të huaja. Gjithashtu ishte kontribues në kishën e fshatit si psalt për shkak dhe të prejardhjes që ai kishte nga nëna. Prej vitit 1990 deri në vdekje ai u spikat me zërin e tij kumbues i cilësuar shpesh herë si tenor metalik me mjaft njohuri dhe eksperiencë muzikale. Me Neço Mukon pati një bashkëpunim të ngushtë për faktin se shkruhet e tij ai i jetësoi duke iu dhënë melodi dhe ritëm mbi 80% të totalit të shkrimeve të tij. Më pas Koço Çakali hodhi themelet e krijimit të grupit të parë polifonike himariote. Ky bashkëpunim mes tyre u përsos dhe u dokumentua në Paris në studion e quajtur PATHE dy herë në vitin 1929 dhe në vitin 1930. Më pas këto regjistrime u shpërndanë në Shqipëri nëpërmjet pllakave gramafonike duke mundësuar që këto krijime të shijoheshin nga audiencia e gjerë. Deri në

vdekjen e tij nuk rreshti së kënduari bukurive të Himarës, patriotizmit me këngët e tij lirike, të lehta, sentimentale dhe humoristike.

➤ Neço Muko

Neço Muko ka lindur më 21 tetor 1899 në një familje autoktone në Himarë ku dhe kreu arsimin prej shtatë klasë. Në vitin 1914 shkon pranë familjes së hallës në Faler, pranë Pireut (Athinë) ku filloi punë (pa të drejtë page) në oficinën e trenave për të mësuar profesionin e mekanikut, ku duke përfituar nga mundësia vijonte mësimet në kurset e mbrëmjes dhe brenda dy vjetëve mori dëshminë e “Ndhmës mjeshtrit trenist”. Kthehet në Himarë në vitin 1916 dhe fillon punë si Sekretar në Zyrën e Nënprefekturës gjer më 1919. Largohet përsëri në Greqi ku krahas punës vazhdoi shkollën dhe fillim të vitit 1923 diplomohet si “mekanik-axhustator i mesëm”. Aty nis e shkruan një pjesë teatrale të titulluar “Ta Pamfaliria”, por që nuk arriti ta vejë në skenë për mungesë financimi, kështu që pas diplomimit rikthehet në vendlindje dhe falë pasionit për këngën vënçe, bëhet organizator dhe drejtues i shoqërisë kulturore “Vetëtima” ku ftoi të ishin pjestarë mësuesi Jani Milo, Panajot Papingji dhe Koço Çakalli. Ky grup vijoi aktivitetin në Himarë deri në muajin mars 1924, pse në këtë muaj Neço Muko merr rrugën e kurbetit në drejtim të Francës duke u nisur nga Saranda me anije, udhëtim që ai e përshkruan me hollësi në një poemë të gjatë me titull “Nga lindja në perëndim”. Në Paris nisi punë në profesionin e tij, por më tepër e shfrytëzoi kohën për njohjen e kulturës franceze, përkthime dhe krijimtari letrare. Pas dy vitesh në Paris nis drejt Saint Etien-it punoi në minierat e qymyrgurit, por dhe aty nuk qëndroi shumë, ndaj pas një qëndrimi të shkurtër në Pire, vendoset në qytetin e Sarandës në vitin 1926 ku hapi një dyqan të vogël. Aty vijnë miqtë e tij Koço Çakalli (që u punësua pranë të atit të Neços, Kristo Muko i cili kishte hapur një rrobaqepsi të vogël në Sarandë) dhe Pano Kokaveshi, (që nisi punë si ndihmës këpucar) dhe duke ftuar në grupimin e ri Andrea Balën dhe Anastas Hariton që banonin në Sarandë, duke rikrijuar grupin “Vetëtima” por duke e quajtur shoqëria “Miqtë e dëfrimit”, madje shpërndan dhe pamfletin “Pif-Paf”. Duhet të theksojmë se në këtë kohë nis punën si kujdestar në konviktin “Çamëria” i ndihmuar nga Hiqmet Roshi.

Në këtë qytet të vogël shkëlqeu talenti dhe madhështia e Neço Mukos, shkruan pa pushim tekste pamfletesh, skeç, tekste këngësh, përkthen nga komeditë e njohura këngë dhe sidomos krijon variantin e ri të këngës (polifonike me iso) himariote që Janko Pali e quan “Avazi himariot”. Ngrenë me shpenzimet e tyre një skenë pranë ish Agjensisë të vjetër në Sarandë, përballë Postës së sotme (ku është vendosur një pllakë përkujtimore) dhe ku gati çdo javë jipnin shfaqje publike duke interpretuar krijimet e Neço Mukos apo dhe këngë të tjera. Shfaqjet e grupit ishin të mirëpritura nga banorët, por Saranda ishte shumë e vogël (rreth 4500 banorë) për talentin e madh të këtij grupi të rinjsh të talentuar. Aty Neço Muko formësoi variantin e ri himariot të këngës vënçe (polifonike me iso), duke i dhënë një rol të ri dhe vendimtar zërit të “hedhësit”. Në këtë kohë pamfleti i tij “Pif-Paf” shpërndahej si suplement i gazetës Demokratia të Gjirokastrës, i publikon krijimet e tij në disa gazeta e revista si “Marrëzia e përgjithëshme”, “Ortsa-Fortsa”, “Tirana qesh” etj, është përkthyes i një operete me titull “Zonja shërbëtore”, krijon ciklin e këngëve qytetare që më vonë do bëhen serenata korçare, ku tekstet e pesë serenatave janë me autor Neço Mukon, organizon karnavalet e Sarandës dhe krijon “Hymni i Karnavaleve” i vetmi në Shqipëri etj.

Duke parë se po zgjerohej shumë gama e krijimeve, vlera, cilësia e veçantia e tyre Neço Muko hedh idenë e inçizimit të tyre jashtë shtetit dhe shpërndarjen në Shqipëri të disqeve bashkë me aparatet e gramafonit që do sillnin ata. Kështu nga mesi i vitit 1929 me

mbështetjen financiare të Andrea Balës dhe Koço Haritos (babai i Anastasit) nisen në drejtim të Parisit nga Saranda Neço Muko, Andrea Bala, Pano Kokaveshi dhe Koço Çakali, të cilëve u bashkohen në Paris Tefta Tashko, Dhimitër (Mitro) Rumbo dhe Tula Paleologu, ku në Shtëpinë diskografike PATHE inçizojnë 12 disqe me këngë mes të cilave Hymni i Flamurit, Atdheu, Ismail Qemali dhe kënga "Vajzë e valeve". PATHE duke mos e njohur efektin e këngës himariote në Shqipëri, me frikën se një dështim i inçizimeve do shërbente si një antireklamë këmbënguli që në njërin anë të disqeve të inçizoheshin këngët popullore himariote dhe në anën tjetër të inçizoheshin këngë të muzikës së lehtë, shqiptare apo të përkthyer nga gjuhët e tjera. Grupi u kthye në Shqipëri në fillim të shtatorit 1929 dhe sukcesi që korri shitja e pllakave së bashku me gramafonët ishte mbresëlënëse, ndërkohë edhe shitja e tyre jashtë vendit në Francë kishte bërë jehonë të madhe. Mbështetur te kërkesat e shumta, por dhe te nevoja e zgjerimit të veprimtarisë grupi bëhet gati për udhëtimin e dytë, këtë herë mbështetur financiarisht nga tregëtari V. Papa. Në përbërjen e grupit në Paris ishin Neço Muko, Koço Çakalli, Andrea Bala, Pano Kokaveshi, Tefta Tashko, Llambi Turtulli dhe Klea Jorga ndërsa nuk shkoj Dhimitër Rumbo dhe u inçizuan 21 pllaka, duke përfunduar inçizimet më 18 korrik 1930. Kthimi në Sarandë në ditët e para të gushtit 1930 u prit me një sekuestrim përmbarimor, pasi tregëtari V. Papa kishte hapur padi për vonesë shlyerje detyrimi financiar dhe sekuestroi gjithë disqet, të cilat i nxorri në shitje me çmim të lartë duke realizuar një fitim maksimal. Gjyqi që hapi Neço Muko nuk i njohu asnjë të drejtë financiare. Neço Muko dhe grupi vazhduan aktivitetin teatror në Sarandë, duke u përpjekur për një udhëtim të tretë. Gazeta Demokratia e Gjirokastrës i bëri thirrje Mbretit për mbështetje financiare të grupit, por kjo ndihmë nuk erdhi kurrë. Me mjetet e tij Neço Muko botoi librin "Lyra" ku përfshiu gjithë krijimet e tija të inçizuara në pllaka, pa përfshirë përkthimet.

Në vitin 1932 Neço Muko ndjeu se po sëmurej dhe u tërhoq nga aktiviteti në Himarë ku ndërroi jetë më 12 dhjetor 1934 në moshën 35 vjeçare.


IV-DISQET DHE KËNGËT E INÇIZUARA

- Disku 44001 "Shqipëria", "Hymni i flamurit", "Marika"
- Disku 44002 "Marshi Mbretëror"
- Disku 44003 "Z. Mersin", "Lule je lule të thonë"
- Disku 44004, "Syzeza", "Uzo, raki, amane"
- Disku 44005 "Pranvera", "Kanakaria"
- Disku 44006 "Vogëlushe"
- Disku 44007, "Shpresa dhe ëndrrat", "Barba Kola"
- Disku 44008, "Saranditja", "Vajzë e malit"
- Disku 44009, "Marrshi i Karnavalit të Sarandës", "Moj Katina nina nina"
- Disku 44010 "Automobili dhe pasaxherët", "Mbeçë more shokë mbeçë"
- Disku 44011 "Dashuria", "Marika"
- Disku 44012, "Gruaja që vret", "Ramona"
- Disku 44013, "Stambollitja", "Varfëria"
- Disku 44014, këngë dasme, "E dëshpëruara"
- Disku 44015, "Dashuria e Parë", "Borziloku"
- Disku 44016, "Daveli", "Tango e trëndafilave"
- Disku 44017 "Mba mend", "Bambumi ..."
- Disku 44018 "Ëndërrat", "Kondispolatia"
- Disku 44019 "Tirana"
- Disku 44020 "Shkodra", "Llaj çobani"
- Disku 44021 "Saranda", "Ismail Qemali",

Disku 44022, "Korçarja e bukur", "Merakliu dhe meraklesha"
Disku 44023, "Valltarja", "Deropolitsia"
Disku 44024 "Jo moj jo"
Disku 44025 "Hurrah, dëfrim", "Lule manushaqe"
Disku 44027 "Mitrushi ushtar"
Disku 44028 "Mitrushi gjellbërës", "Sorkadhjka e malit"
Disku 44029, "Ushtarët... ", "Nëntëqint e dhjetë viti"
Disku 44030, "Çifti i bukur", "Minush Aga", "Naze naze puna jote"
Disku 44031, "Kthimi në nisi", "Çerçiz Topulli"
Disku 44232 "Aristokrati e popullori", "Pabesa"
Disku 44033 "Vajz e valëve"
Disku 44034, "Bostanxhiu dhe shërbëtorja", "Mitrushi në Paris",
Disku 44035, "Marveshja e mirë"
Disku 44036, "Doli hëna dritë ergjënda", "Le t'i lutemi zotit"

Në përfundim këshilli artistik vendosi të zgjedh emrin Neço Muko. Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në ligjin nr. 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", kërkojmë miratimin e emrit Neço Muko për sallën multifunkionale të bashkisë, nga ana e Këshillit Bashkiak.

DREJTORI
Andon Xani



DREJTORIA JURIDIKE
Klelli Muharemi



KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro

